



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Fier, më ____ .12.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Karburanti (*Gazoil deri ne 10 ppm dhe benzine pa plumb*)” me 2 lote:

Loti 1: Blerje gazoil deri në 10 ppm

Loti 2: Blerje benzine pa plumb

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09134100-8 - Karburant diesel ; 09132100-4 – Benzinë pa plumb

VLERA E FONDIT LIMIT TË PËRBASHKËT TOTAL : Fondi limit / vlera e pritshme e përgjithëshme e kontratës: **94 356 040** (*nëntëdhjetë e katër milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyzet*) lekë pa TVSH **ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 19.12.2023): 915 455.9** (*nenteqind e pesëmbëdhjetë mijë e katerqind e pesëdhjetë e pese pike nente*) **Euro**.

Fondi limit total i ndarë sipas autoriteteve kontraktore përfituese:

1. Fondi limit i Ndërmarrjes së Pastrimit Fier është në vlerën prej **32 367 550** (*tridhjetë e dy milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë*) lekë pa tvsh dhe **38 841 060** (*tridhjetë e tetë milion e tetëqind e dyzet e një mijë e gjashtëdhjetë*) lekë me tvsh.
2. Fondi limit i Ndërmarrjes së Gjellbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier është në vlerën prej **5 600 170** (*pesë milion e gjashtëqind mijë e njëqind e shtatëdhjetë*) lekë pa tvsh dhe **6 720 204** (*gjashtë milion e shtatëqind e njëzet mijë e dyqind e katër*) lekë me tvsh .
3. Fondi limit i Bashkisë Fier është në vlerën **4 637 100** (*katër milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind*) lekë pa tvsh dhe **5 564 520** (*pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzet*) lekë me tvsh .

4. Fondi limit i kontratës e Bashkisë Fier (për Drejtoria e Shërbimit të M.Z.SH. Fier) është në **4 637 100** (katër milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind) lekë pa tvsh dhe **5 564 520** (pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzet) lekë me tvsh .
5. Fondi limit i Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit Fier është në vlerën **18 548 400** (tetëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë e katërqind) lekë pa tvsh dhe **22 258 080** (njëzet e dy milion e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë) lekë me tvsh.
6. Fondi limit i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Fier është në vlerën **15 272 700** (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind) lekë pa tvsh dhe **18 327 240** (tetëmbëdhjetë milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e dyzet) lekë me tvsh.
7. Fondi limit i Ndërmarrjes së Shërbimeve Rurale Fier është në vlerën **13 293 020** (trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëzet) lekë pa tvsh dhe **15 951 624** (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) lekë me tvsh.

Loti 1: Blerje gazoil deri në 10 ppm – 91 969 150 (nëntëdhjetë e një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nentë mijë e njëqindë e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 19.12.2023): 892 297.95** (teteqind e nentëdhjetë e dy mije e dyqind e nentëdhjetë e shtatë pike nentëdhjetë e pese) **Euro.**

Fondi limit për Lotin nr.1, i ndarë sipas autoriteteve kontraktore përfituese:

1. Fondi limit i Bashkisë Fier është në vlerën prej **4 637 100** (katër milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind) lekë pa TVSH.
2. Fondi limit i Ndërmarrjes së Pastrimit Fier është në vlerën prej **32 150 560** (tridhjetë e dy milion e njëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.
3. Fondi limit i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Fier është **14 838 720** (katërmëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH.
4. Fondi limit i Ndërmarrjes së Shërbimeve Rurale Fier është **13 293 020** (trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëzet) lekë pa TVSH.
5. Fondi limit i Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit Fier, është **18 548 400** (tetëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë e katërqind) lekë pa TVSH.
6. Fondi limit i Ndërmarrjes së Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier, është **3 864 250** (tre milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqindë e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
7. Fondi limit i Bashkisë Fier (për nevojat e Drejtorisë së Shërbimit të M.Z.SH. Fier), është **4 637 100** (katër milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind) lekë pa TVSH.

Loti 2: Blerje benzine pa plumb - 2 386 890 (dy milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e teteqind e nentedhjetë) lekë pa TVSH ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 19.12.2023): 23 157.95 (njezet e tre mije e njeqind e pesedhjetë e shtate pike nentedhjetë e pese) Euro.

Fondi limit për Lotin nr.2, i ndarë sipas autoriteteve kontraktore përfituese:

1. Fondi limit i Ndërmarrjes së Pastrimit Fier është në vlerën prej **216 990** (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.
2. Fondi limit i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Fier është **433 980** (katërqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.
3. Fondi limit i Ndërmarrjes së Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier, është **1 735 920** (një milion e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e njezet) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier (ne rolin e organit qendor bleses) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1: BLERJE GAZOIL DERI NË 10 PPM

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës nr.8

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Autorizim (*Licensë*) e vlefshme e stacionit te tregtimit me pakice te karburanteve per ushtrimin e veprimtarise, leshuar nga organi kompetent ne zbatim te ligjit nr.8450 datë 24.02.1999, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë*” nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.1.2. Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentin e pronesise (*shoqeruar me hartën treguese hipotekore*) **ose** kontraten noteriale të qirasë me afat te pakten deri me **31.12.2024** (*me te njejtin dokumentacion bashkangjitur*), te stacionit te tregtimit me pakice te karburanteve, stacion i cili duhet te jete ne territorin e Bashkisë Fier.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat ligjore.

Stacioni i tregtimit me pakicë i karburantit eshte kerkuar te jete ne territorin e Bashkisë Fier për të pasur mbulim sa më të mirë të furnizimit përgjatë ushtrimit të aktivitetit të Bashkise dhe enteve vartese. Gjithashtu nisur dhe nga fakti qe Bashkia Fier (dhe entet e saj vartese) jane pergjegjese per administrimin, miremenaxhimin dhe ushtrimin e detyrave te veta jo vetem ne qytetin e Fierit por edhe ne 9 njesite administrative te saj.

2.1.3. Operatori ekonomik duhet te paraqese Vërtetim teknik lëshuar nga ISHTI ose nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), për respektimin e normave dhe kushteve teknike të stacionit të tregtimit me pakicë të karburanteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat ligjore dhe duke respektuar normat dhe kushtet teknike te stacionit të tregtimit me pakicë të karburanteve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2021, 2022**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues eshte ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit¹.* Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht ne ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten sic eshte parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperme eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2021, 2022**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **150 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 1**). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*; në piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku percaktohet se: **Pika 1.** *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* **Pika 2/a:** *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepërmjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperm është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/a e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë, perkatesisht; Pika 2/a: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;* Duke qenë se kjo procedure prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit mbi kufirin e lartë monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohej dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se **30 000 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 1**), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shënohen datat, shumat, zerat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e ketij kriteri

behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojes se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2. Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike:

- a- Flete analize ose raport analize i cilesise per **Gazoil deri 10 ppm**, leshuar nga organet kompetente të ngarkuara me ligj, e leshuar jo me pare se 3 muaj nga data e hapjes së tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, gërmes c pika 6 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi **ose** me qera 1 (nje) autobot me kapacitet mbajtës jo me pak se **10 m³**.

- **Pronesia** e autobotit te vertetohet si me poshte:

Ofertuesi duhet te paraqesë, lejen e qarkullimit te mjetit rrugor ne emer te ofertuesit, siguracion te vlefshem, akt kolaudimi te vlefshem, taksat vjetore.

- **Mjeti i marre me qira sipas pikes se mesiperme**, vertetohet me kontraten e qiramarrjes ose te huaperdorjes te lidhura para noterit, me afat vlefshmerie per te gjithë afatin e zbatimit te kontrates per kete objekt prokurimi dhe e shoqeruar me dokumentacionin, lejen e qarkullimit te mjetit rrugor, siguracion te vlefshem, akt kolaudimi te vlefshem, taksat vjetore.

Shenim: Për pikën 2.3.3 më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën 2.3.3, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Shënim: Operatorët ekonomike të cilët do të paraqesin ofertat/ konkurrojnë për me shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikës 2.2.2., dhe përvojën e ngjashme sipas pikës 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 2: BLERJE BENZINË PA PLUMB

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës nr.8

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Autorizim (*Licensë*) e vlefshme e stacionit të tregtimit me pakice të karburanteve për ushtrimin e veprimtarisë, leshuar nga organi kompetent në zbatim të ligjit nr.8450 datë 24.02.1999, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë*” nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.1.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentin e pronesisë (*shoqeruar me hartën treguese hipotekore*) **ose** kontratën noteriale të qirasë me afat të pakten deri me **31.12.2024** (*me të njejtin dokumentacion bashkangjitur*), të stacionit të tregtimit me pakice të karburanteve, stacion i cili duhet të jete në territorin e Bashkisë Fier.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat ligjore.

Stacioni i tregtimit me pakicë i karburantit është kërkuar të jete në territorin e Bashkisë Fier për të pasur mbulim sa më të mirë të furnizimit përgjatë ushtrimit të aktivitetit të Bashkisë dhe enteve vartese. Gjithashtu nisur dhe nga fakti që Bashkia Fier (dhe entet e saj vartese) janë përgjegjëse për administrimin, mirëmbajtjen dhe ushtrimin e detyrave të veta jo vetëm në qytetin e Fierit por edhe në 9 njesite administrative të saj.

2.1.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Vërtetim teknik** lëshuar nga ISHTI ose nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), për respektimin e normave dhe kushteve teknike të stacionit të tregtimit me pakicë të karburanteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat ligjore dhe duke respektuar normat dhe kushtet teknike të stacionit të tregtimit me pakicë të karburanteve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2021, 2022**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuara se: *4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit². Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetin ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2021, 2022**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **900 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 2**). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare

konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në perputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;* në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se: Pika 1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* Pika 2/c: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/c: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;* Bazuar në fondin limit, ky lot është nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet*

e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; .

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se **400 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 2**), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit të lotit 2, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit të lotit 2, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojese se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2. Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike:

- a-** Flete analize ose raport analize i cilesise per **Benzinë pa plumb**, lëshuar nga organet kompetente të ngarkuara me ligj, e lëshuar jo me pare se 3 muaj nga data e hapjes së tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, gërmes c pika 6 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Shënim: Operatoret ekonomike te cilet do te paraqesin ofertat/ konkurrojnë per me shumë se nje lot, duhet te plotesojne kriteret e veçanta,xhiron vjetore sipas pikes 2.2.2., dhe pervojen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: Ne respekt te nenit 36 te ligjit nr.16 date 23.012.2020 “Per prokurimin public” per cdo standart ose emertim marke te permendur pranohet dhe ekuivalenti i tyre. Kriteret teknike te kualifikimit jane hartuar nga specialisti i fushes.

Specifikimet teknike jane vendosur ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Per Lotin 1 : Blerje gazoil deri në 10 ppm Specifikimet teknike jane në përputhje me standartin S SH EN 590: 2013+A1:2017 (ose ekuivalent), sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri dhe per Lotin 2 : Blerje benzinë pa plumb jane në përputhje me standartin S SH EN 228:2012 + A1:2017 (ose ekuivalent), sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri. Specifikimet teknike jane percaktuar nga specialisti i fushes.

Specifikimet teknike gjenden pjese perberese e DST ne SPE.